



BPrAL - PPOHE
Kolegji AAB

DEGA - GJAKOVË

***DREJTIMI: MENAXHMENT DHE INFORMATIKË
& MARKETING DHE ADMINISTRIM BIZNESI***

Lënda:

INFORMATIKA E BIZNESIT


Mësimdhënësi

MSc.Florent Bunjaku, PhD cand.

Viti akademik 2014/2015

NOCIONI I SISTEMIT

- Me nocionin e sistemit nënkuptojmë çdo grupim i përbërë prej më së paku dy elementeve të cilat përmes interaksionit realizojnë ndonjërin prej funksioneve të tërësisë, të thjeshtë apo të përbërë.




Me çka menaxhohet

- Winer ka përcaktuar se proceset e menaxhimit përfshijnë tri elemente: sistemin, informatat dhe proceset.
- Sistemet përbëhen nga njerzit, sendet dhe proceset ku paraqesin bashkësinë e elementeve të cilat janë të bashkuar në mes veti bëhen lëndë reale e menaxhimit.
- Vetë e rëndësishme e secilit sistem është qëllimi (caku) i tij. Kjo është arsyeja e ekzistimit të tij.

Si menaxhohet

- Me sisteme menaxhohet ashtu që me ndihmën e lidhjes kthyesë ndikohet në lëvizjen e tyre në hapësirën e gjendjes së sistemit.
- Me aplikimin e lidhjes kthyesë, me ndihmën e informatave, sistemi lëviz në hapësirën e gjendjes.
- Sistemi mund të funksionojë në hapësirën e lejuar dhe të mundshme të gjendjes.

QARKU RREGULLUES DHE LIDHJA KTHYESE (FEED BACK)



Qarku rregullues

I – Inputet (madhësitë hyrëse)
P – Pengesat – Inputet e papritura
X – Njësia qeverisëse (menaxhuese)
Y – Njësia e qeverisur
T – Procesori transformues
SK – Sinjalet korrektuese
SQ – Sinjalet qeverisëse
O – Outputet (madhësitë dalëse)
LK – Lidhja kthye (Feed back)

- Me lidhjen kthye realizohet funksioni i kontrollit (vetëkontrollit) mbi punës e sistemit si dhe cilësitë (vlerat) dalëse të tij.
- Në kohën më të re qarku rregullativ zakonisht quhet Sistem administrues (qeverisës). Funksioni kontrollues i një sistemi të tillë realizohet me mekanizmin e lidhjes kthye, gjegjësisht me qasje të drejtëpërdrejtë të tiparet dalëse.

ENTROPIA

- Në teorinë e sistemeve entropia është:
 - Masë e çrregullimit dhe e mosfunksionimit të sistemit
 - Masë e pasigurisë së parashikimit të sjelljes së sistemit në të ardhmen
 - Masë transparencës së sistemit, përkatësisht e mundësisë së sigurimit të një pasqyre të sjelljes ekzistuese të sistemit
- Në teorinë e informatave entropia është:
 - Masë e sasisë së nevojshme të informatave për qeverisje me sisteme
- Shkalla maksimale e entropisë në ndërmarrje do të jetë falimentimi i saj.

DERIVATET E KIBERNETIKËS

- Rëndësi të veçantë kanë këto derivate të kibernetikës:
 - Teoria e komunikimit
 - Teoria e vendosjes
 - Teoria e programimit
 - Teoria e lidhjes kthyesë
 - Teoria e përgjithshme e sistemeve

Teoria e komunikimit	Teoria e informatave Teoria e kodimit Teoria e shenjave
Teoria e vendosjes	Vendosja racionale Vendosja intuitive Vendosja heuristike
Teoria e programimit	Teoria e algoritmeve Teoria e automateve
Teoria e lidhjes kthyese	Teoria teknike e lidhjes kthyese Teoria sociale e lidhjes kthyese
Teoria e përgjithshme e sistemeve	Koncepti i funksionit të sistemit Koncepti i entropisë Koncepti i qarkut rregullues Koncepti i marrëdhënieve me rrethinën Koncepti i specializimit dhe diferencimit Koncepti holistik Koncepti teleologjik Koncepti i ekuifinalitetit

TEORIA E KOMUNIKIMIT

- Teoria e informatave (*sasia dhe cilësia e informatave*)
- Teoria e kodimit (*shëndrimi i shenjave, simboleve apo sinjaleve nga një formë në tjetrën*)
- Teoria e shenjave (*mundësia e lidhjes së tyre në një tërësi të kuptueshme*)

TEORIA E VENDOSJES

- Vendosja racionale (*kur për gjdo opcion të mundshëm egzistojnë informata të sakta gjatë marrjes së vendimeve*)
- Vendosja intuitive (*gjatë marrjes së vendimeve nuk ka informata të sakta*)
- Vendosja heuristike (*harmonizon veprimet në mes të dy metodave racionale dhe intuitive*)

TEORIA E PROGRAMIMIT

- Teoria e algoritmeve (*zgjidhja e problemit përmes hapave të caktuar*)
- Teoria e automateve (*konstrukcioni i mundshëm algoritmik i makinave, për kryerjen e disa operacioneve fizike ose logjike*)

TEORIA E LIDHJES KTHYESE (FEED BACK)

- Teoria e teknike e lidhjes kthyese (*makina, stabilimente, reparte etj.*)
- Teoria e sociale e lidhjes kthyese (*grupe shoqërore*)

TEORIA E PËRGJITHSHME E SISTEMEVE (TPS)


- Funkzioni i sistemit (*rrezikohet nga entropia*)
- Koncepti hierarkik (*marëdhënjet midis sistemit, nënsistemit dhe mbisistemit gjatë kryerjes së detyrave*)
- Koncepti i diferencimit dhe specializimit (*çdo element apo nënsistem kryen një funksion parcial*)
- Koncepti holistik (*nga ideja “tërësia është më e madhe se shumica e pjesëve”*)
- Koncepti teleologjik (*të gjitha elementet e sistemit janë orjentuar nga arritja e qëllimit*)
- Koncepti i ekuifinalitetit (*qëllimi i njejtë mund të arrihet me metoda të ndryshme*)

INFORMATIKA

INFORMATIKA = IFORMATA + AUTOMATIKA

Qasja
Sistemore

KIBERNETIKA



INFORMATIKA

TRENDET E ZHVILLIMIT TË INFORMATIKËS SË BIZNESIT

Njohja e trendeve të zhvillimit të informatikës së biznesit është e rëndësishë së veçant ku do të përmendim

TRENDE POZITIVE:

- Vendosjen e elementeve të teknologjisë informative në një numër të madhë të **produkteve** dhe shërbimeve
- Zhvillimi gjithnjë e më i madhë i **produkteve të reja** të bazuara në përdorimin e elementeve të teknologjisë informative
- Rritjen e ndikimit të teknologjisë informative në ndryshimin e mardhënieve **shoqërore, prodhuese** dhe **afariste**
- Përshtatjen e **strategjisë afariste** me lloje të reja dhe të përsosura të prodhimeve dhe shërbimeve të teknologjisë informative
- Rritjen e ndikimit të teknologjisë Informative në rritjen e llojeve të afarizmit dhe të rezultateve të tij financiare (**zvoglimi i shpenzimeve** të afarizmit dhe **rritja e fitimit**)
- Ndikimin intenziv në ndryshimin e rolit të menaxhmentit në sistemet afariste, i cili manifestohet me **rritjen e kontrollit** mbi funksionimin e sistemit

TRENDE NEGATIVE:

- Trendet e cekura në parim duhet konsideruar si pozitive sepse mund të përshpejtojnë përfitimet e përgjithshme shoqërore. Vërejmë edhe disa trende **negative** siq janë:
 - Rritja e rrezikut të **keqpërdorimit** të teknologjisë informatike për përfitime joligjore,
 - Rritja e **kriminalitetit** kompjuterik/informatik,
 - **Zvoglimi i komunikimit** personal midis njerëzve, respektivisht rritja e komunikimit jo verbal e cila mundë të ketë si pasojë izolimin social të individit etj.
- Këto trende **negative** të zhvillimit të informatikës së biznesit duhet të mbahen nën kontroll, nëse nuk mund të eliminohen në tërësi


SISTEMI INFORMATIK -TERMET THEMELORE

- **Sistemi** paraqet bashkësi të elementeve të cilët formojnë tërësi dhe ndërmjet të cilëve ekzistojnë lidhje të caktuara
- **Cilësitë** e sistemit apo të pjesëve të tija quhen **attribute**
- Sistemi posedon **hyrje, dalje** dhe **rrethinë**
- Sistemi mundë të jetë **natyral** apo **artificial**, i **thjeshtë** apo i **ndërlikuar** e tj.
- Sistemi posedon lidhje (është në **interakcion**) me rrethinën

SISTEMI INFORMATIK

➤ **SISTEMI INFORMATIK** mundë të definohet si:

“një bashkësi e elementeve të ndërlidhura të cilat me atributet e tyre mundësojnë përpunimin elektronik të të dhënave”



Inputet dhe outputet e sistemit informatik

- Sistemi informatik përbëhet nga njerzit dhe pajisjet, kurse detyrë e tij është mbledhja e të dhënave, përpunimi, memorimi dhe transmetimi i tyre.
- Sistemi informatik proceson informata nga të dhënat, përkatësisht ai transferon inputet në outpute sipas nevojave dhe kërkesave për informata.
- Sistemi informatik paraqet sistem **DINAMIK** – me kohë dhe nën ndikimin e rethinës ndryshojnë elementet e tij e me këtë edhe vet sistemi në tërësi.

ORGANIZIMI I SISTEMIT INFORMATIK DUHET TË SIGUROJ:

- Inkuadrimin e të gjitha qëllimeve të sistemit,
- Minimizimin e aktiviteteve të dyfishta në procesimin e informatave, si dhe menjanimin e konflikteve midis projekteve zhvillimore,
- Motivimin e personelit,
- Nxitjen e interakcionit midis nënsistemeve të cilat duhet të sigurojnë efikasitetin e punës së sistemit informatik.

Profilet e ekspertve të nevojshëm në një sistem informatik të menaxhmentit do të ishin:

- Specialistët për softverin e sistemit,
- Specialistët për bazën e të dhënave,
- Projektuesit,
- Analitikët sistemor,
- Programerët,
- Specialistët për hardver - në rastë se ndërmarja organizon mirëmbajtjen vetanake të sistemit informatik.

LLOJET E SISTEMIT INFORMATIK

- Varësisht nga marrëdhënja midis inputeve dhe outputeve sistemet informatike mundë të jenë:
- **Sisteme neutrale-** kur inputi i tyre është i barabartë me outputin dhe ky sistem themi se është vetëm transmetues i informatave.
- **Sisteme të informuara-** kur inputet janë më të mëdha se outputet pra sistemi i tillë është pasiv, sepse më tepër mer informata nga sistemet tjera, se sa që i përpunon ato.
- **Sistemi informatik qeverisës-** është sistem kreativ, inputet e tij janë më të vogla se outputet. Gjatë procesit të përpunimit të të dhënave krijon cilësi të re, prandaj themi se ky sistem është në funksion të qeverisjes.

SISTEMI INFORMATIK I BIZNESIT

- Sistemi informatik i biznesit paraqet sistemin informatik i cili ka për detyrë të sigurojë informata të sakta, relevante dhe me kohë për strukturën menaxheriale, të cilat do të ishin bazë gjatë procesit të marrjes së **vendimeve afariste**.

Nënsistemi informatik i blerjes dhe materialit i cili përmban:

- fajllin lidhur me planifikimin dhe kontrollin e mallrave dhe materialit (mallrave komerciale, shërbimeve, paketimin e materialit etj.)
- fajllin e llogarisë së shitjes së produkteve, sasinë e shitjes me shumicë,
- fajllin e materialit,
- fajllin e furnizuesve
- fajllin e bilancit të furnizuesve.

➤ **Nënsistemi informatik i shitjes me shumicë** përmbanë:

- fajllin e kontratave me konsumator,
- fajllin e porosive,
- fajllin e fakturave dhe shitjes
- fajllin e konsumatorëve, fajllin e bilancit të konsumatorëve.

➤ **Nënsistemi informatik i shitjes me pakicë** përmbanë:

- fajllin e shitoreve, llogarinë e shitjes me pakicë, katalogun e mallrave (listën e çmimeve), rezervat minimale dhe maksimale, inventarin e shitoreve,
- fajllin e shitjes së mallrave përmes rrjetit.

- **Nënsistemi informatik i kontabilitetit** përmban:
 - llogaritë financiare dhe operacionet financiare


- **Nënsistemi informatik i vlersimit të kapitalit** përmban:
 - fajllin e llogarisë së vlersimit të kapitalit dhe të mirëmbajtjes.

- **Nënsistemi informatik i kontrollit të prodhimit** i cili do të ofron informata lidhur me komponentat e prodhimit, procedurat teknologjike, planin prodhues, dokumentacionin prodhues dhe shpenzimet e prodhimit.

FAZAT E ZHVILLIMIT TË SISTEMIT INFORMATIK TË BIZNESIT

- Cikli jetësor i sistemit karakterizohet me disa faza të zhvillimit:
 - Faza iniciale (e krijimit) të sistemit – iniciativa për zhvillimin e sistemit informatik zakonisht vjen nga menaxherët e ndërmarrjes të cilët kanë nevojë për informim më të mirë,
 - Faza e ekspansionit (rritjes) të sistemit – duke investuar mjete e dituri të konsiderueshme vërehet një rritje kuantitative e sistemit në të gjitha segmentet e tij. Sigurohen pajisjet dhe programet, përgatiten kuadrot dhe komponentet rrjetore të sistemit,
 - Faza e konsolidimit – rëndësi e veçantë i kushtohet standardizimit dhe harmonizimit të punës së të gjitha komponenteve. Plotësimi i kiterëve të kualitetit siguron kalimin në
 - Fazën e pjekurisë ku sistemi siguron rezultate optimale, prandaj synohet që kjo fazë të zgjasë sa më shumë dhe të kompenzohen shpenzimet e bëra në fazën e konsolidimit.

CIKLI JETËSOR I SISTEMIT



SISTEMI INFORMATIK I NDËRMARRJES DHE NËNSISTEMI I TIJ

- ✓ Njësia organizative – sektori i sistemit informatik
- ✓ Komponenta lifewere e sistemit informatik – programerët
- ✓ Teknologjia informative – hardweri dhe softweri




Sistemi informatik i ndërmarrjes dhe elementet e tij

NËNSISTEMET E SISTEMIT INFORMATIK TË NDËRMARRJES JANË

- ✓ Nën sistemi informatik i prodhimit,
- ✓ Nën sistemi informatik i furnizimit me lëndë të parë dhe material,
- ✓ Nën sistemi informatik i marketingut,
- ✓ Nën sistemi informatik i financave dhe kontabilitetit,
- ✓ Nën sistemi informatik i personelit,
- ✓ Nën sistemi informatik procesues.

NDËRMARRJA DHE SISTEMI INFORMATIK

- Faktorët që ndikojnë në interaksionin në mes të ndërmarrjes dhe sistemit informatik janë:
 - ✓ Struktura organizative
 - ✓ Rrethina afariste
 - ✓ Proceset afariste
 - ✓ Vendosja menaxheriale




Relacioni dykahësh midis ndërmarrjes dhe teknologjisë informatve

Ndërmarrja mund të definohet si një strukturë e thjeshtë sociale e cila merr inputet nga rrethina i përpunon ato, për të prodhuar outpute të cilat ia dërgon rrethinës.

Ky definicion fokusohet në tri elemente:


- Kapitalin
- Fuqinë punëtore
- Teknologjinë informative



ROLI I RI SISTEMIT INFORMATIV NË NDËRMARRJE

Sistemi informativ ndikon në mënyrë direkte se si menaxherët:

- ✓ I marrin vendimet
- ✓ Planifikojnë
- ✓ Si prodhohen produktet
- ✓ Si kryhen shërbimet




SI NDIKON NDËRMARRJA NË SISTEMIN INFORMATIV

Së pari duhet të jepet përgjigje në pyetjet:

- ✓ Si e përdorë aktualisht ndërmarrja sistemin informativ?
- ✓ Sa ka ndryshuar roli organizativ i ndërmarrjes si rezultat i aplikimit të teknologjisë informative?
- ✓ Kush punon në sistemin informativ?

Faktorët të cilët ndikojnë në aplikimin e teknologjisë informative në ndërmarrje janë:

- ✓ Faktorët e jashtëm (rrethina)
- ✓ Faktorët e brendshëm (institucionale)



SI NDIKON SISTEMI INFORMATIV NË NDËRMARRJE

Sistemi informativ duhet ta ndihmojë ndërmarrjen që:

- ✓ Të kuptojë dhe të përcjellë ndryshimet,
- ✓ Të shkurtojë rrugën e qarkullimit të informatave,
- ✓ Të zvoglojë shpenzimet dhe të rrisë të ardhurat,
- ✓ Të zvoglojë shpenzimet menaxhmentit.

Sistemi informativ i menaxhmentit të biznesit


- ✓ Sistem i cili siguron informata të nevojshme në funksion të marrjes së vendimeve cilësore,
- ✓ Inputet e sistemit informativ të menaxhmentit janë më të vogla se outputet.

KOMPONENTET E SISTEMIT INFORMATIV TË MENAXHMENTIT TË BIZNESIT

Komponentet e sistemit informativ të menaxhmentit të biznesit janë:

- ✓ Komponenti materialo teknik (*hardwer, përmban makinat, paisjet etj. për përpunimin e informacioneve*)
- ✓ Komponenti jomaterial (*softwer, tërësia e diturisë njerzore e instaluar në makina*)
- ✓ Komponenti njerëzor (*lifewer, shfrytëzojnë rezultatet e përpunimit të të dhënave*)
- ✓ Komponenti transmetues (*netwer, bartjen e të dhënave gjegjësisht mjetet telekomunikative*)
- ✓ Komponenti organizativ (*orgwer, harmonizimi i katër komponenteve të lartëcekura për krijimin e një tërësie*)


Të gjitha komponentet janë në interaksion ku komponenti organizativ (orgweri) luan rrolin kryesor



SISTEMI INFORMATIV I BIZNESIT DHE MENAXHMENTIT

Teoria e menaxhmentit nënkupton ekzistimin e tri niveleve:

- ✓ Niveli i lartë – strategjik (top management)
- ✓ Niveli i mesëm – ekzekutiv (middle, executive management)
- ✓ Niveli i ulët – operativ (operative management)



- Niveli i lartë – janë këshilli mbikqyrës dhe drejtues i subjektit afarist, pastaj drejtori eventualisht këshilltarët e tij,
- Niveli i mesëm – udhëheqësit ekzekutiv të shërbimeve të caktuara,
- Niveli i ulët – udhëheqësit e sektoreve të caktuara (repartëve, projekteve, programeve etj.) brenda çdo shërbimi të caktuar

- Linja (zinxhiri) i udhëheqjes është i drejtuar nga lartë – poshtë, ndërsa përgjegjësia nga poshtë - lartë